

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

ANIMACION SOCIAL

Niveli II

**(Në drejtimin mësimor
”Shërbime sociale dhe shëndetësore”)**

Kodi: O3-II-18

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2018

Përmbajtja:

- I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Animacion social”, niveli II, të drejtimit mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Animacion social”, niveli II.**
 1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Animacion social”, niveli II
 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Animacion social”, niveli II
 3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Animacion social”, niveli II
 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në profilin “Animacion social”, niveli II.
- III. Plani mësimor për profilin “Animacion social”, niveli II.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor.**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Animacion social”, niveli II.**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**
- X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Animacion social”, niveli II, të drejtimit “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Animacion social”, niveli II, të drejtimit “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet e animatorit social”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Animacion social”, niveli II

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Animacion social”, niveli II

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Animacion social” niveli II, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli I;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit në profilin “Animacion social”, niveli II

Në përfundim të arsimit profesional në profilin “Animacion social”, niveli II, nxënësi do të



zotërojnë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale e rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë, nisur nga kritere të drejta, si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Animacion social”, niveli II.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Animacion social”, niveli II, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin I, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të konceptojë planin për hapjen e një biznesi të vogël në animacion social.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me veprimtaritë e animacionit social.
- Të bëjë organizimin e vogël të punës
- Të zbatojë etikën profesionale të animatorit social
- Të zbatojë ligjshmërinë përkatëse të shërbimit të animacionit për të gjitha grupmoshat
- Të zbatojë parimet e garantimit dhe respektimit të të drejtave të njeriut
- Të zbatojë rregullat specifike të komunikimit gjatë animacionit social
- Të zbatojë rregullat e etikës dhe të sjelljes profesionale gjatë animacionit
- Të përzgjedhë dhe mirëmbajë pajisjet dhe materialet e punës sipas veprimtarive në animacion social
- Të hartojë një program social në varësi të llojit të veprimtarisë.
- Të zbatojë parimet e punës në grup
- Të harojë dhe zbatojë një plan menaxhimi të rrezeve të ndryshme në një aktivitet social
- Të animojë në mënyrë të pavarur grupe të ndryshme sipas nevojave të tyre
- Të reagojë në mënyrë konstruktive ndaj sjelljeve të ndryshme nga ana e pjesëtarëve të një komuniteti të caktuar.
- Të demonstrojë vetëmotivim, iniciativë dhe disiplinë të nevojshme për të ofruar projekte krijuese në përputhje me buxhetin, materialet dhe kohën në dispozicion
- Të dizajnojë modele, sfonde, karaktere dhe objekte për një projekt animacioni të përcaktuar.



– Të planifikojë, monitorojë dhe raportojë për mbarëvajtjen e projektit social.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Animacion social”, niveli II.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Animacion social”, niveli II, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në qendra rezidenciale ose ditore për fëmijë, në shërbimet komunitare të përkujdesjes, në spitale, për t’u vetëpunësuar si animator social ose, mbas një përvoje pune, për të krijuar një biznes të vogël në fushën e shërbimeve të animacionit social.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimit në nivelin III (teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin profesional ‘Shërbime sociale dhe shëndetsore’, për të fituar diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Animacion social”, niveli II

Plani mësimor për profilin mësimor “Animacion social”, Niveli II			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/ vjetore
			Klasa 12
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	8/9 (272/306)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		TIK	1
7		Edukim fizik, sporte, shëndet	1
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	7 (238)
1	L-17-157-10	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-20-460-17	Njohuri për animacionin social	3
3	L-20-461-17	Psikologji e zhvillimit	2
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	12 (408)
1	M-20-1389-17	Etika dhe sjellja profesionale në animacion social	51
2	M-20-1390-17	Parandalimi dhe menaxhimi i konflikteve	69
3	M-20-1391-17	Dinamikë grupi	51
4	M-20-1392-17	Organizimi i veprimtarive kulturore	84



5	M-20-1393-17	Dekor dhe punë dore	69
6	M-20-1394-17	Lojërat	84
D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	3 (102)
1	M-20-1395-17	Animacion në kontekstin turistik	102
2	M-20-1396-17	Zhvillimi i sjelljes shoqërore dhe autonomisë të grupmosha të ndryshme	102
		Gjithsej A+B+C+D	30/31 (1020/ 1054)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Animacion social”, niveli II, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritetit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmëshjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënësit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat



profesionale të profilit mësimor “Animacion social”, niveli II.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Metoda e simulimit* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale të kujdestarit për fëmijë në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “Animacion social”.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Animacion social”, niveli II, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar.

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e Shërbimeve sociale dhe shëndetësore për fëmijëit, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit II.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Animacion social”, niveli II

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Animacion social”, niveli II, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Çertifikatën e aftësisimit profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale;
 - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit II.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-10). Kl. 12 – 68 orë

- Synimet e lëndës “ Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “ Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë sipërmarrjen me të gjithë elementet kryesore të saj.
- Të shpjegojnë lidhjen midis sipërmarrjes dhe veprimtarisë njerëzore.
- Të shpjegojnë ndikimin e sipërmarrjes në biznes.
- Të shpjegojnë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes.
- Të përshkruajnë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në të.
- Të përshkruajnë llojet e konsumatorëve, kërkesat specifike për mallra/shërbime dhe reagimet e tyre ndaj sinjaleve të marketingut të një sipërmarrjeje.
- Të shpjegojnë kuptimin e institucioneve financiare dhe rolin e tyre në biznes.
- Të shpjegojnë kuptimin e bankave dhe shërbimet e tyre.
- Të shpjegojnë kuptimin, rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut.
- Të listojnë katër *P*-të e marketingut.
- Të përshkruajnë konceptet bazë të legjislacionit dhe etikës së biznesit.
- Të shpjegojnë rëndësinë e legjislacionit të punës dhe elementet përbërës të tij.
- Të kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës.
- Të shpjegojnë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 - 68 orë

Tema 1	Njohuri të përgjithshme mbi sipërmarrjen	3 orë
Tema 2	Sipërmarrja dhe aktiviteti njerëzor	4 orë
Tema 3	Sipërmarrja dhe biznesi	8 orë
Tema 4	Organizimi i punës në biznes	9 orë
Tema 5	Tregu dhe sjellja konsumatore	6 orë
Tema 6	Institucionet financiare	7 orë
Tema 7	Njohuri për Marketingun	5 orë
Tema 8	Legjislacioni dhe etika e biznesit	5 orë
Tema 9	Legjislacioni i punës	7 orë
Tema 10	Llogaritje të thjeshta ekonomike	10 orë
Tema 11	Aspekte të TIK-ut në biznes	4 orë

2. Lënda “Njohuri për animacionin social” (L-20-460-17). Kl. 12 – 102 orë

• Synimet e lëndës “Njohuri për animacionin social”, kl. 12

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Njohuri për animacionin social”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajë natyrën dhe filozofinë e animacionit social.
- Të përshkruajë rëndësinë e shërbimeve të animacionit social në zhvillimin e marrëdhënieve shoqërore, ashtu edhe për ruajtjen e një shëndeti të mirë fizik e mendore.
- Të përshkruajë konceptet bazë të legjislacionit në fushën e shërbimit social.
- Të rendisë karakteristikat e një animatori social.
- Të identifikojë grupmoshat dhe probemet e tyre.
- Të përshkruajë natyrën e sjelljes njerëzore në një mjedis social.
- Të rendisë fazat e formimit të grupit social.
- Të përshkruajë fazat e hartimit dhe zbatimit të një plani veprimi/projekti social.
- Të përshkruajë llojet e animacionit.
- Të identifikojë teknikat e animacionit.
- Të përshkruajë llojet e dekoreve në animacion
- Të identifikojë metodat për gjithëpërfshirjen e individëve në aktivitet.
- Të përshkruajë rëndësinë e njohjes së heterogjenitetit motivues dhe emocional të individëve.
- Të identifikojë situatat e rrezikshme gjatë një aktiviteti social.
- Të listojë parimet e ndërhyrjes në menaxhimin e konflikteve.
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë në animacion.
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Njohuri për animacionin social”, kl. 12- 102 orë:

Tema 1	Njohuri të përgjithshme mbi animacionin social	3 orë
Tema 2	Rëndësia e shërbimeve të animacionit social	3 orë
Tema 3	Legjislacioni mbi sigurinë e jetës në aktivitetet sociale	4 orë
Tema 4	Karakteristikat e animatorit social	6 orë
Tema 5	Identifikimi i grupmoshave dhe problemet e tyre	6 orë
Tema 6	Natyra e sjelljes njerëzore të moshave të ndryshme	6 orë
Tema 7	Fazat e formimit të grupit social	7 orë
Tema 8	Hartimi i një plani/projekti social	8 orë
Tema 9	Llojet e aktiviteteve të animacionit	8 orë
Tema 10	Teknikat e animacionit	9 orë
Tema 11	Dekori në animacion	9 orë
Tema 12	Metodat e gjithëpërfshirjes së individëve në aktivitet	5 orë
Tema 13	Motivimi	5 orë
Tema 14	Situatat e rrezikshme gjatë një aktiviteti social	6 orë
Tema 15	Parimet e ndërhyrjes në menaxhimin e konflikteve	6 orë
Tema 16	Teknologjia dhe animimi	6 orë
Tema 17	Rregullat e mbrojtjes së mjedisit	5 orë

3. Lënda “Psikologjia e zhvillimit” (L-20-461-17). Kl. 12 - 68 orë

- Synimet e lëndës “Psikologjia e zhvillimit”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Psikologjia e zhvillimit”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë zhvillimin fizik në fëmijëri
- Të përshkruajnë zhvillimin fizik të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe atyre me nevoja të veçanta
- Të listojnë karakteristikat e zhvillimit social në fëmijëri
- Të përshkruajnë zhvillimin biologjik në adoleshencë.
- Të shpjegojnë fazën e pubertetit dhe mënyrat e përjetimit të tij.
- Të përshkruajnë zhvillimet sociale dhe problemet që shfaqen në adoleshencë.
- Të përshkruajnë karakteristikat e marrëdhënieve njerëzore në moshën e rinisë dhe moshën e mesme
- Të tregojnë bazat e një komunikimi të përshtatshëm me të moshuarin sipas moshës së tij
- Të përshkruajnë sjelljet dhe qëndrimet e duhura ndaj të moshuarve me probleme të moshave të ndryshme
- Të përshkruajnë aspektet sociale dhe nevojat e individëve të moshës së tretë
- Të përshkruajnë disa nga sëmundjet e moshës së tretë dhe shërbimet e nevojshme për të moshuarit e kësaj moshe
- Të përshkruajnë mënyrën e komunikimit me familjarët për situatat e vështira shëndetësore të sjelljes apo raste ekstreme të të afërmit të tyre
- Të përshkruajnë mbështetjen që ofrohet për të moshuarit me sëmundje të rënda dhe për ata që janë në prag të vdekjes

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Psikologji e zhvillimit”, kl.12 - 68 orë

Tema 1	Zhvillimi fizik në fëmijëri	4 orë
Tema 2	Zhvillimi i të menduarit dhe gjuhës	4 orë
Tema 3	Karakteristikat e zhvillimit social në fëmijëri	5 orë
Tema 4	Fëmijët me aftësi të kufizuar dhe ata me nevoja të veçanta	5 orë
Tema 5	Zhvillimet sociale dhe problematika e moshës së adoleshencës	5 orë
Tema 6	Marrëdhëniet njerëzore në moshën e rinisë dhe atë të mesme	6 orë
Tema 7	Zhvillimet karakteristike të moshës së mesme	6 orë
Tema 8	Moshimi	8 orë
Tema 9	Njohuri mbi funksionet biologjike të të moshuarve	7 orë
Tema 10	Aspektet sociale dhe nevojat e të moshuarve	7 orë
Tema 11	Sëmundjet tipike të moshës së tretë	7 orë
Tema 12	Përballja me vdekjen	4 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli “Etika dhe sjellja profesionale në animacion social”

Drejtimi: Shërbime sociale dhe shëndetësore
Profili: Animacion social
Niveli: II
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	ETIKA DHE SJELLJA PROFESIONALE NË ANIMACION SOCIAL	M-20-1389-17
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson nxënësit për të zbatuar parimet e etikës dhe të sjelljes profesionale në animacionin social.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi evidenton ndërgjegjen profesionale <i>Përmbajtja:</i> <ul style="list-style-type: none">- Analiza e përgjegjësive të personelit përgjegjës të aktivitetit.- Vlerësimi i përgjegjësive të personelit të aktivitetit për higjienën dhe mbrojtjen e mjedisit- Transmetimi i informacionit të shkruar dhe gojor- Transmetimi i informacionit specifik në lidhje me aktivitetin në grupmosha të ndryshme- Transmetimi i informacionit tek kujdestarët social- Respektimi i sekretit profesional- Bashkëpunimi në organizimin e shërbimit. <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të analizojë rëndësinë e rolit të personelit përgjegjës të aktivitetit.- të vlerësojë përgjegjësinë për higjienën dhe mbrojtjen e mjedisit- të transmetojë informacionin e shkruar dhe gojor- të transmetojë informacionin specifik në lidhje me aktivitetin në grupmosha të ndryshme	

- të transmetojë informacionin te kujdestarët social (prindërit, të afërmit dhe pjesëmarrës të ndryshëm)
- të respektojë sekretin profesional
- të bashkëpunojë në organizimin e shërbimit

RM 2 Nxënësi zbaton parimet themelore të animacionit social.

Përmbajtja:

- Zbatimi i parimit të punës në ekip
- Shfaqja e durimit dhe dashurisë ndaj të gjithë pjesëmarrësve në aktivitet
- Ruajtja e vëmendjes dhe buzëqeshjes së vazhdueshme
- Respektimi i botës së brendshme të pjesëmarrësve në aktivitet
- Informimi dhe këshillimi i kujdestarëve social
- Krijimi i klimës së respektit dhe mirëbesimit reciprok
- Ndërtimi i marrëdhënieve të ngrohta sociale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të vlerësojë parimin e punës në ekip
- të ruajë durimin, dashurinë ndaj të gjithë pjesëmarrësve në aktivitet.
- të ruajë vëmendjen dhe buzëqeshjen e vazhdueshme
- të respektojë botën e brendshme të pjesëmarrësve në aktivitet
- të informojë dhe këshillojë kujdestarët social duke zbatuar procedurat përkatëse
- të krijojë një klimë respekti dhe mirëbesimi reciprok me pjesëmarrësit
- të ndërtojë marrëdhënie të ngrohta sociale me pjesëmarrësit në aktivitet.

RM 3 Nxënësi zbaton kodin e etikës në animacion social

Përmbajtja:

- Respektimi i autonomisë së pjesëmarrësve në aktivitet
- Demonstrimi i sjelljes bamirëse dhe i dashurisë njerëzore
- Respektimi i të drejtave të njeriut
- Përcaktimi i përgjegjësisë së plotë gjatë zhvillimit të aktiviteteve sociale
- Demonstrimi i dashurisë ndaj profesionit dhe ambicjes profesionale
- Demonstrimi i vendimmarrjes etiko-profesionale
- Demonstrimi i kënaqësisë profesionale
- Përballimi i vështirësive dhe pengesave

-
- Zgjidhja e konflikteve
 - Identifikimi i veçorive dhe kërkesave të individëve pjesëmarrës në aktivitet

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të respektojë autonominë e pjesemarrësve në aktivitet
- të demonstrojë sjellje bamirëse dashuri njerëzore
- të respektojë të drejtat e njeriut
- të përcaktojë drejt përgjegjësitë gjate zhvillimit të aktiviteteve sociale
- të demonstrojë dashuri ndaj profesionit dhe ambicje profesionale
- të demonstrojë aftësi të vendimmarrjes etiko-profesionale
- të demonstrojë kënaqësi profesionale gjatë punës
- të përballojë me sukses vështirësitë dhe pengesat që mund të dalin gjatë punës
- të zgjidhë me sukses konfliktet dhe mosmarrëveshjet e ndryshme
- të bëjë identifikimin e veçorive dhe kërkesave të individëve pjesëmarrës në aktivitet

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasa teorie, në çerdhe, kopshte dhe shkolla, spitale, azile, shtëpi pushimi, komunitet, qendra sociale, qendrat e shëndetit mendor etj.
- Mësuesi duhet të referojë saktë për etikën dhe ndërgjegjen profesionale të animatorit social.
- Nxënësit duhet të përqëndrohet dhe angazhohet në punë konkrete ku të demonstrojë etikën dhe ndërgjegjen profesionale të animatorit social.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i zbatimit të njohurive të marra dhe i ushtrimit praktik të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Klase teorie, çerdhe dhe kopshte fëmijësh, spitale, azile, shtëpi pushimi, komunitet, qendra sociale, qendrat e shëndetit mendor etj.
 - Mjete të tjera për të realizuar simulimin e situatave të ndryshme të aktiviteteve të ndryshme të animacionit social
 - Materialet ndihmëse, kartela, regjistra, formularë, ngjyra, tullumbace, akrilik, shkumsa, kartona etj.
 - Udhëzues, katalogë, rregullore etj.
-

2. Moduli “Parandalimi dhe menaxhimi i konflikteve”

Drejtimi: Shërbime sociale dhe shëndetësore
Profili: Animacion social
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PARANDALIMI DHE MENAXHIMI I KONFLIKTEVE	M-20-1390-17
Qëllimi i modulit	Nje modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për parandalimin dhe menaxhimin e konflikteve ne te gjitha aktivitetet qe ata do te zhvillojne	
Kohëzgjatja e modulit	69 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përshkruan llojet e konflikteve. Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">- Evidentimi i llojeve të konfliktiteve- Përshkrimi i rëndësisë së zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit- Përshkrimi i rëndësisë së njohjes së heterogjenitetit motivues dhe emocional të individëve që marrin pjesë në aktivitet.- Zhvillimi i mënyrave të ndryshme të qasjes së konflikteve- Zbatimi i shprehive të reja të menaxhimit të konfliktit në grupmosha të ndryshme që marrin pjesë në aktivitet- Zhvillimi i aktiviteteve ndihmuese në njohjen rasteve të konfliktit në eventet e ndryshme Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë- Vëzhgim me listë kontrolli Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të kryejë evidentimin e llojeve te konflikteve- të përshkruajë rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit social- të përshkruaj rëndësinë e njohjes së heterogjenitetit motivues dhe emocional të individëve që marrin pjesë në aktivitet.- të zhvilloj mënyra të ndryshme të qasjes së konflikteve- të zbatojë shprehi të reja të menaxhimit të konfliktit në grupmosha të ndryshme që marrin pjesë në aktivitet	

- të zhvilloj aktivitete ndihmuese në njohjen e rasteve të konfliktit në eventet e ndryshme

RM 2 Nxënësi përshkruan dhe zbaton disa teknika te përballimit dhe zgjidhjes së konfliktit.***Përmbajtja***

- Përshkrimi i teknikave dhe modeleve të komunikimit sipas rrethanave të ndryshme
- Listimi i parimeve të ndërhyrjes në menaxhimin e konflikteve;
- Shpjegimi i përdorimit të teknikave të menaxhimit të konflikteve dhe situatave të vështira gjatë veprimtarisë që zhvillon
- Menaxhimi i situatave konfliktuale gjatë një veprimtarie social

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje përgjigje me gojë

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë teknikat dhe modelet e komunikimit sipas rrethanave të ndryshme
- të listojë parimet e ndërhyrjes në menaxhimin e konflikteve;
- të shpjegojë përdorimin e teknikave të menaxhimit të konflikteve dhe situatave të vështira gjatë veprimtarisë që zhvillon
- të menaxhojë situatat e konflikteve gjatë një veprimtarie social

RM 3 Nxënësi zbaton zgjidhje krijuese të konflikteve.***Përmbajtja***

- Ndërtimi i marrëdhënie midis individëve ose grupeve shoqërore;
- Reagimi në mënyrë konstruktive ndaj sjelljeve të ndryshme nga ana e pjesëtarëve të një komuniteti të caktuar;
- Demonstrimi i vetë-motivimit, iniciativës dhe disiplinës së nevojshme për të ofruar projekte kreative në përputhje me buxhetin dhe kohën në dispozicion;
- Drejtimi dhe marrja e përgjegjësisë të një veprimtarie në mënyrë dinamike dhe aktive
- Demonstrimi i origjinalitetit në zbatimin e njohurive dhe teknikave të reja për një problem krijues;
- Përdorimi i teknikave të ndryshme të negocimit pa

imponuar zgjidhjen e tij;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të ndërtojë marrëdhënie midis individëve ose grupeve shoqërore;
- të reagojë në mënyrë konstruktive ndaj sjelljeve të ndryshme nga ana e pjesëtarëve të një komuniteti të caktuar;
- të demonstrojë vetë-motivim, iniciativë dhe disiplinë të nevojshme për të ofruar projekte kreative në përputhje me buxhetin dhe kohën në dispozicion;
- të drejtojë dhe të marrë përgjegjësitë e një aktiviteti në mënyrë dinamike dhe aktive
- të demonstrojë origjinalitet në aplikimin e njohurive dhe teknikave të reja për një problem krijues;
- të përdorë teknika të ndryshme negocimi pa imponuar zgjidhjen e tij;

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasa teorie, në çerdhe dhe kopshte fëmijësh, spitale , azile , shtepi pushimi, komunitet, qendra sociale, qendrat e shendetit mendor etj.
- Mësuesi duhet të referojë saktë për perballimin dhe menaxhimin e konfliktit që kryen animatori social.
- Ai duhet të përdorë dhe metodat e punës në grupe, lojës me role dhe simulimit
- Nxënësit duhet të përqëndrohet dhe angazhohet në punë konkrete ku të demonstrojë teknika kreative të përballimit dhe të menaxhimit të konflikteve si animator social.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i zbatimit të njohurive të marra dhe i ushtrimit praktik të tyre.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klaseteorie, çerdhe dhe kopshte fëmijësh, spitale, azile, shtepi pushimi, komunitet, qendra sociale, qendrat e shendetit mendor etj.
 - Individë në nevojë social-shëndetësore ose manekinë
 - Mjete të tjera për simulimin e situatave të ndryshme të aktiviteteve të ndryshme të animacionit social
 - Materialet ndihmëse, kartela, regjistra, formularë, ngjyra, tullumbace ,akrilik, shkumsa , kartona,etj.
 - Udhëzues, katalogë, rregullore, etj.
-

3. Moduli “Dinamikë grupi”

Drejtimi: Shërbime sociale dhe shëndetësore
Profili: Animacion social
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	DINAMIKE GRUPI	M-20-1391-17
Qëllimi i modulit	Nje modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për organizimin e grupit dhe teknikat e punës në grup	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi komunikon me individët që do formojnë grupin. Përmbajtja <ul style="list-style-type: none">- Prezantimi i vetes- Prezantimi i individëve që do formojnë grupin.- Zhvillimi i teknikave „thyerje akulli“.- Evidentimi i kërkesave/nevojave të thëna/paraqitura dhe të nënkuptuara- Evidentimi i nevojave specifike të individëve pjesëmarrës.- Prezantimi i rëndësisë së ruajtjes së mjedisit si mënyrë jetese në komunitet. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të prezantojë veten.- të mundesojë prezantimin e individëve që do formojnë grupin.- të zhvillojë teknika thyerje akulli me qëllim krijimin e një klime sa më të mirë bashkëpunimi.- të evidentojë kërkesat/nevojat e thëna/paraqitura dhe të nënkuptuara.- të evidentojë nevojat specifike të individëve pjesëmarrës.- të prezantojë rëndësinë e ruajtjes së mjedisit si mënyrë jetese në komunitet.	

RM 2 Nxënësi planifikon veprimtarinë e grupit***Përmbajtja***

- Organizimi i vendit të punës.
- Përcaktimi i objektivave të punës.
- Ndarja e detyrave dhe roleve në një veprimtari sociale.
- Hartimi i një programi social për mosha të ndryshme.
- Përzgjedhja e teknikës së duhur në varësi të hapësirës dhe kohës në dispozicion.
- Ndërtimi i marrëdhënieve midis individëve ose grupeve shoqërore.
- Menaxhimi në mënyrë konstruktive i sjelljeve të ndryshme nga ana e pjesëtarëve të grupit.
- Mbështetja dhe nxitja e pjesëmarrjes aktive të grupit përmes proceseve motivuese të përfshirjes.
- Përcatimi i llojit të informacionit sipas nevojave dhe interesave të grupmoshave të ndryshme.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të organizojë vendin e punës
- të përcaktojë objektivat e punës.
- të ndajë detyrat dhe rolet në një aktivitet social
- të hartojë një program social për mosha të ndryshme
- të përzgjedhë teknikën e duhur në varësi të hapësirës dhe kohës në dispozicion
- të ndërtojë marrëdhënie midis individëve ose grupeve shoqërore
- të menaxhojë në mënyrë konstruktive sjelljet e ndryshme nga ana e pjesëtarëve të grupit.
- të mbështesë dhe nxisë pjesëmarrjen aktive të grupit përmes proceseve motivuese të përfshirjes
